



KËRKESË PËR OFERTË

Lënda: Shërbim Produksioni – Realizimi i 40 episodeve per podcast-in n’Rini.

Instituti për Zhvillim dhe Edukim do të realizojë projektin “n’Rini” në kuadër të programit TEYC 2022. Qëllimi i n’Rini është të jetë një podcast qe të trajtojë tema me rendesi per te rinjte dhe ku ne focus do te jene vete ato. Shtator-Dhjetor 2022, në Tiranë dhe rrethe.

Për të mbuluar këtë shërbim, Instituti për Zhvillimit dhe Edukim ka hapur procedurën e prokurimit “Shërbim Produksioni – Realizimi i 40 episodeve per podcast-in n’Rini”.

Qëllimi dhe objektivat:

Qëllimi kryesor i shërbimit të kërkuar është realizimi i 40 episodeve per podcasting n’Rini

Shërbimi i kërkuar konsiston në:

- Xhirimi i podcastit në studio për 30 episode.
- Realizimi i podcasteve speciale jashtë studios për 10 episode
- Editimi i podcastit për 40 episode
- Editim i teaser per 40 episode
- Edimi i audio spotify per 40 episode
- Realizimi i eksperimenteve speciale, Vox pop, interviste, brenda dhe jashtë Tiranës per 40 episode

Për realizimin e këtyre dy shërbimeve, Ofruesi i Shërbimit duhet të jetë i gatshëm të ofrojë shërbimin sipas këtyre kerkesave:

- Xhirimi i episodeve në mënyrë profesionale në studio.
- Xhirime në terren të episodeve speciale
- Të editojë audion për platformën spotify
- Të xhirojë eksperimentet sociale, vox pop apo intervista ne terre
- Të editoje episode sipas kerkesave te klientit
- Të përgatise video të shkurta për promovim

Kushtet për Shërbimin:

Ruajtje e konfidencialitetit të të dhënave që mund të krijohen ose zbulohen nga mbledhja dhe interpretimi i informacioneve gjatë punës;

Gatishmëri në përmbushjen e detyrimeve lidhur me shërbimin e kërkuar dhe kapacitete për sigurimin e cilësisë së lartë të produktit;



Përkushtim për sigurimin dhe dorëzimin e produktit sipas afatit kohor të përcaktuar dhe të dakordësuar në kontratën e bashkëpunimit;

Lëshim i faturës së rregullt tatimore për shërbimin e ofruar, shoqëruar me raportin e punës;

DOKUMENTAT E KËRKUAR

Për të marrë pjesë në këtë procedurë tenderimi, Ofruesi i Shërbimit duhet të dorëzojë:

- NIPT dhe Ekstraktin e Subjektit;
- Ofertën ekonomike të ndarë sipas zërave të kërkesës dhe në total.
- Prezantim të shkurtër të profilit të kompanisë;
- Në ofertën e tij subjekti i interesuar duhet të japë të dhëna të sakta të personit të kontaktit;

PROCESI, METODAT DHE KRITERET E VLERËSIMIT

Propozimet do të vlerësohen bazuar në analizën kumulative, duke marrë parasysh kombinimin e kualifikimeve të aplikantit dhe propozimit financiar. Kontrata duhet t'i jepet aplikantit, oferta e të cilit është vlerësuar dhe përcaktuar si:

E pajtueshme/e pranueshme teknikisht;

Duke marrë rezultatin më të lartë nga një grup i paracaktuar kriteresh teknike dhe financiare të ponderuara specifike për kërkesën.

Kohëzgjatja e shërbimit: 4 muaj

Numri total i episodeve 40

DORËZIMI I DOKUMENTACIONIT:

Dokumentacioni duhet të paraqitet në një zarf të mbyllur, të firmosur dhe vulosur nga individët/ subjektet aplikues, me mbishkrimin "Shërbim Produksioni – Realizimi i 40 episodeve per podcast-in n'Rini." brënda të cilit të jenë vendosur në dy zarfa të veçantë Propozimi Teknik (zarfi 1) dhe Propozimi Financiar (zarfi 2), të mbyllur, të firmosur dhe vulosur nga individët/ subjektet aplikues.

Propozimi financiar duhet të plotësohet sipas formës Formulari i Ofertës– Aneks 1 bashkëngjitur kësaj Ftese për Ofertë.



Mosvendosja e ofertës financiare në një zarf të mbyllur dhe të veçuar nga zarfi i propozimit financiar, do të sjellë skualifikim.

Aplikimet duhet të dorëzohen në gjuhën shqipe.

Dorëzimi i dokumentacionit duhet të bëhet në adresën e mëposhtme:

Rr, Dytësore Tiranë-Durrës, Rr. "Agron", Kompleksi "Bengasi", K.2, Ap.7, Tiranë, Shqipëri

AFATI I DORËZIMIT TË OFERTAVE:

Afati i fundit kohor për dorëzimin e ofertave do të jetë data: 30 Shtator 2022, ora 10:00.

Afati i fundit kohor për pyetje sqaruese do të jetë data: 29 Shtator 2022, ora 14:00.

(Lutemi të kontaktoni në adresën elektronike gr.topjana@hotmail.com. për pyetje lidhur me procesin.)

Mbani parasysh se kjo adresë elektronike mund të përdoret vetëm për pyetje sqaruese dhe jo për dorëzim ofertash. Çdo ofertë që do të dërgohet në këtë adresë elektronike do të skualifikohet.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin, mbetemi në pritje të Ofertës suaj,

Instituti per Zhvillim dhe Edukim

HAPJA ZYRTARE E OFERTAVE:

Të gjithë ofertuesit janë të ftuar të marrin pjesë në procesin e hapjes zyrtare të ofertave:

Në datën: 03 Tetor 2022, ora 10:00.

Në adresën: Rr, Dytësore Tiranë-Durrës, Rr. "Agron", Kompleksi "Bengasi", K.2, Ap.7, Tiranë, Shqipëri

AFATI I DORËZIMIT TË OFERTAVE:

Ofertuesit duhet të jenë të pajisur me autorizimin përkatës nga kompania/ individi pjesëmarrës në proces dhe një mjet identifikimi, për të qenë prezent në hapjen e ofertave, si përfaqësues zyrtar i kompanisë/ individit.

Në rast se asnjë kompani/ individ nuk paraqitet në procesin e hapjes zyrtare të ofertave, procesi do të vijojë normalisht.



Metoda e Vlerësimit:

Cilësia e propozimeve teknike do të vlerësohet në përputhje me kriteret e dhënies dhe peshën përkatëse siç detajohet më poshtë:

- Përmbushja e kriterëve teknike (50 pikë)
- Çmimi i propozuar për shërbimin (50 pikë)

(Propozimet të cilat nuk arrijnë të marrin të paktën 49 pikë për kriteret teknike të vlerësimit nuk do të konsiderohen për vlerësim të mëtejshëm)

KUSHTET / DETYRIMET E PËRGJITHSHME

Kontraktuesi do të përfundojë detyrën e përcaktuar në Termat e Referencës për këtë kontratë me kujdesin e duhur, efikasitetin dhe eficiencën, në përputhje me teknikat dhe praktikën profesionale të dakordësuara. Gjatë kohëzgjatjes së kësaj kontrate, Kontraktuesi duhet të përmbahet nga çdo sjellje që mund të ndikojë negativisht në veprimtarinë e KRRK dhe nuk duhet të përfshihet në asnjë aktivitet që është në kundërshtim me udhëzimet administrative dhe politikat dhe procedurat e Institutit për Zhvillim dhe Edukim. Kontraktuesi duhet të ushtrojë diskrecionin maksimal në të gjitha çështjet që lidhen me këtë kontratë.

Përveçse kur autorizohet ndryshe nga zyrtari përkatës i Institutit për Zhvillim dhe Edukim, Kontraktuesi nuk duhet t'i komunikojë në asnjë moment medias ose ndonjë institucion, person, qeverie ose subjekt tjetër jashtë Institutit për Zhvillim dhe Edukim, çdo informacion që nuk është bërë publik. Kontraktuesi nuk mund ta përdorë këtë informacion pa autorizimin me shkrim të Institutit për Zhvillim dhe Edukim dhe në asnjë rrethanë nuk do ta përdorë këtë informacion për përfitimin e tij ose të saj privat ose të të tjerëve. Këto detyrime nuk shuhen me përfundimin e kontratës.